

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sika® CarboDur® E

PETËZA PREJ FIBRASH KARBONI TË PËRFTUARA NGA PROCESI I PULTRUZIONIT PËR PËRFORCIM STRUKTURASH SI PJESË E SISTEMIT SIKARBOBUR®

### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Petëzat Sika® CarboDur® E janë pllaka fibrash karboni të përforcuara me polimere (CFRP) të cilat janë përftuar nga procesi i pultruzionit, të dizenuara për të përforcuar betonin, drurin, muret, çelikin dhe strukturat polimere të përforcuara me fibra.

Petëzat Sika® CarboDur® E ngjiten tek struktura si një përforcim i jashtëm me ngjitësin Sikadur®-30 me bazë rrëshire epokside për temperatura normale, ose me ngjitësin me bazë rrëshire epokside Sikadur®-30. Ju lutemi referohuni tek skeda teknike përkatëse për më tepër informacione të detajuara rreth adezivit.

### PËRDORIMET

Sika® CarboDur® E duhet të përdoret vetëm nga profesionistë me përvojë.

Sistemet Sika® CarboDur® E përdoren për të përmirësuar, rritur apo riparuar performancën dhe rezistencën e strukturave për:

*Kapaciteti i shtuar për bartje ngarkese:*

- Rritje e kapacitetit bartës të pllakave të dyshemeve, trarëve dhe seksioneve të urave
- Për instalimin e makinerive të rënda
- Për stabilizim të strukturave vibruese
- Për ndryshim të përdorimit të ndërtesës

*Dëmtim i elementeve strukturore për shkak të:*

- Përkeqësimit të materialeve origjinale të ndërtimit
- Korrodimit të armaturës prej çeliku
- Aksidenteve (goditje nga automjeti, tërmete, zjarr)

*Përmirësim i shërbimit dhe qëndrueshmërisë:*

- Reduktim i shformimeve dhe gjerësisë së plasaritjes
- Reduktim i sforcimit të armaturës prej çeliku
- Rezistencë e përmirësuar ndaj lodhjes

*Ndryshim i sistemit strukturor:*

- Heqje muresh dhe / ose kolonash
- Heqje e dyshemeve dhe pjesëve të murit për të krijuar akses / hapje

*Rezistencë ndaj ngjarjeve të mundshme:*

- Rezistencë e shtuar ndaj tërmete, goditjes apo shpërthimit, etj.

*Riparim të defekteve të dizenjimit ose ndërtimit si:*

- Armim i pamjaftueshëm / i papërshtatshëm
- Thellësi strukturore e pamjaftueshme / e papërshtatshme

### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Jo korrodues
- Rezistencë shumë e lartë
- Qëndrueshmëri e shkëlqyer
- Gjatësi të pakufizuara, nuk kërkohen bashkime
- Trashësi e ulët sistemi, ekzekutim i thjeshtë i kryqëzimeve
- Transportim i lehtë (rulona)
- Peshë e lehtë, i thjeshtë për t' u instaluar, sidomos në aplikime të sipërme (pa suport të përkohshëm)
- Përgatitje minimale e petëzës, aplikim në disa shtresa
- Skaje të lëmuara, pa fibra të ekspozuara si pasojë e prodhimit nga pultruzioni
- Disponohen testime dhe miratime

### INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Ambalazhi</b>	Rulona 5, 25 dhe 100 m
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Fibra karboni të përforcuara me polimere në matricë vinil esteri të zeze.
<b>Jetëgjatësia</b>	E pakufizuar
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Pa ekspozim në rrezatim të drejtpërdrejtë diellor (dritë UV), në kushte të thata dhe temperatura max. 50°C

Dendësia	1.55 g/cm <sup>3</sup>			
Përmasat	<b>Lloji</b>	<b>Gjerësia</b>	<b>Trashësia</b>	<b>Sipërfaqja e prerjes tërthore</b>
	Sika® CarboDur® E 512	50 mm	1.2 mm	60 mm <sup>2</sup>
	Sika® CarboDur® E 514	50 mm	1.4 mm	70 mm <sup>2</sup>
	Sika® CarboDur® E 812	80 mm	1.2 mm	96 mm <sup>2</sup>
	Sika® CarboDur® E1014	100 mm	1.4 mm	140 mm <sup>2</sup>
	Sika® CarboDur® E1214	120 mm	1.4 mm	168 mm <sup>2</sup>
Përmbajtja e vëllimit të fibrave	> 70 %			

## TË DHËNA TEKNIKE

<b>Rezistenca e fletës ndaj tërheqjes</b>	<b>Mesatare</b> 2200 N/mm <sup>2</sup> <small>Vlerat në drejtimin gjatësor të fibrave * 5 % fractile</small>	<b>Karakteristike*</b> 2000 N/mm <sup>2</sup>	(ASTM D3039)
<b>Moduli i elasticitetit i fletëve në tërheqje</b>	<b>Mesatar</b> 180 kN/mm <sup>2</sup> <small>Vlerat në drejtimin gjatësor të fibrave * 5 % fractile</small>	<b>Karakteristik*</b> 170 kN/mm <sup>2</sup>	(ASTM D3039)
<b>Zgjatimi deri në thyerje i fletëve</b>	<b>Mesatar</b> 1.22 % <small>Vlerat në drejtimin gjatësor të fibrave * 5 % fractile</small>	<b>Karakteristik*</b> 1.18 %	(ASTM D3039)
<b>Reagimi ndaj zjarrit</b>	Nëse kërkohet nga rregulloret lokale, petëzat Sika® CarboDur® E mund të mbivishen gjithashtu me materiale mbrojtjeje kundër zjarrit.		

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

<b>Struktura e sistemit</b>	Ndërtimi dhe konfigurimi i sistemit duhet të zbatohet plotësisht siç përshkruhet dhe nuk duhet të ndryshohet.		
	Rrëshira për ngjitjen	Sikadur®-30	
	Petëza karboni për përforcim strukturor (CFRP)	Sika® CarboDur® E	
	Për informacione të detajuara rreth Sikadur®-30, ju lutemi referohuni tek skeda teknike e Sikadur®-30 dhe tek "Method Statement për Përforcimin me Ngjitje të Jashtme Sika® CarboDur®"		

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

<b>Konsumimi</b>	<b>Gjerësia e petëzës CarboDur®</b>	<b>Konsumimi tipik i Sikadur®-30</b>
	50 mm	0.25–0.35 kg/m
	80 mm	0.40–0.55 kg/m
	100 mm	0.55–0.80 kg/m
	120 mm	0.65–1.00 kg/m

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS

#### **Petëzat Sika® CarboDur® E me ngjitje të jashtme mbi sipërfaqen e betonit:**

Rezistenca minimale e rekomanduar e betonit ndaj tërheqjes pas përgatitjes së sipërfaqes:

- Mesatare: 2.0 N/mm<sup>2</sup>
- Minimale: 1.5 N/mm<sup>2</sup>

Rezistenca efektive e betonit ndaj tërheqjes pas përgatitjes së sipërfaqes duhet të verifikohet.

Kur rezistenca e betonit ndaj tërheqjes është më e ulët se kërkesat minimale, disponohen zgjidhje alternative nga Sika®:

- CarboDur® i aplikuar brenda hapjeve si një përforsim i montuar pranë sipërfaqes (NSM)
- Pëlhurat SikaWrap®: Ju lutemi referohuni tek skeda tekniket të pëlhurave SikaWrap®

Në përgjithësi, betoni duhet të ketë moshë më të vjetër se 28 ditë (në varësi të kushteve të trajtimit dhe llojit të betonit etj.)

#### **Sika® CarboDur® E me ngjitje të jashtme mbi nënshtresa të tjera:**

Për aplikimin e petëzave Sika® CarboDur® mbi të gjitha nënshtresat e tjera (tulla, gur, çelik, dru, polimer i përforsuar me fibra, etj.) ju lutemi referohuni tek Method Statementose kontaktoni me shërbimin teknik Sika për këshilla të detajuara.

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Betoni duhet të pastrohet dhe të përgatitet për të arritur një sipërfaqe pa kore dhe kontaminime me teksturë të hapur.

Ju lutemi referohuni gjithashtu tek Method Statement për informacione të mëtejshme.

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

Ju lutemi referohuni tek skedat teknike përkatëse e Sikadur®-30 dhe tek Method Statement.

## DOKUMENTA SHITESË

#### **Method Statement**

Përforsimi Sika® CarboDur® me ngjitje të jashtme, Ref: 850 41 05

## KUFIZIME

- Duhet të këshilloheni me një inxhinier strukturash specialist për çdo përllogaritje të dizajnit të projektimit.
- Për shkak se ky aplikim është strukturor, përzgjedhja e kontraktorëve specialistë me përvojën dhe trajnimin e duhur duhet bërë me shumë kujdes.
- Sistemet e përforsimit Sika® CarboDur® E me petëzat Sika® CarboDur® E duhet të mbrohen nga ekspozimi i përhershëm ndaj rrezatimit diellor, lagështia dhe/ose uji. Ju lutemi referohuni tek Method Statement dhe skedat teknike përkatëse për përzgjedhjen e materialeve të përshtatshme për mbiveshje, në situata ku sistemet do të jenë pjesërisht ose

plotësisht të ekspozuara.

- Temperatura max. e lejuar shërbimit të vazhdueshëm është ~ +50°C.
- Ju lutemi referohuni gjithashtu tek Method Statement përkatëse për kufizime dhe udhëzime të mëtejshme
- Kontaktoni me shërbimin teknik Sika për këshilla të detajuara

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

### RREGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park  
Ndërtesa nr. 7, kati 4  
Tiranë - Shqipëri  
Tel.: +355 4 454 0070  
alb.sika.com  
Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit  
Sika® CarboDur® E  
Qershor 2019, Botimi 01.01  
020206010010000044

SikaCarboDurE-sq-AL-(06-2019)-1-1.pdf